



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 985 prot.

Tepelenë, më 03.06.2025

V E N D I M

Nr. 34, datë 30.05.2025



“PËR MIRATIM DHËNIE NDIHME FINANCIARE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA ZJARRI”

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e datës 30.05.2025 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tepelenë, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e zotit Fatmir Bejko fshati Dukaj, njësia administrative Qender, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri, nga buxheti i bashkisë dhe i Ministrisë së Mbrojtjes për emergjencat civile për vitin 2023, në zbatim të ligjit nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ , neni 29 “komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku e bashkie” Neni 30 ku përcaktohen detyrat e bashkive dhe përkatësisht gërma “gj” ku shprehet: “kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre si dhe dëmshperblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre”, neni 41 “E drejta e kompensimit”, VKM Nr.329 date 16.05.2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Neni III, pika ë) “ Këshilli bashkisë, pas shqyrtimit të relacionit të Komisionit të Emergjencave në bashki, proces-verbalit të konstatimit të gjëndjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ”.

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tepelenë për mbështetje financiare të shtetasit Fatmir Bejko, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Tepelenë.

3. Ti akordoj familjes së shtetasit Fatmir Bejko, ndihmën emergjente në vlerën 234786.3 lekë, nga fondi i emergjencave civile i miratuar për vitin 2025.

4. Ndihma financiare për familjen e mësipërme, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012.

5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë të familjes së shtetasit Fatmir Bejko.

6. 3. Ky vendim hyn ë fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI



Miratuar me 11 (njëmbëdhjetë) vota

Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë)vota

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 03.06.2025